

Shtator 2026

Të nderuara familje,


Mirë se riktheheni në shkollë! Po ju shkruaj për t'ju përcjellë informacion të rëndësishëm lidhur me përpjekjet tona për të garantuar sigurinë dhe mbarëvajtjen e mësimi për të gjithë nxënësit tanë, veçanërisht për familjet tona emigrante dhe pa dokumente. Edhe unë jam emigrant dhe dua të jem i qartë: Shkollat Publike të qytetit të Nju-Jorkut (New York City Public Schools, NYCPS) mirëpresin dhe u shërbejnë të gjithë fëmijëve, pavarësisht statusit të tyre të emigracionit.

Shkollat tona u përkasin të gjitha familjeve tona. NYCPS nuk kërkon dhe nuk gjurmon informacion lidhur me statusin e emigracionit të nxënësve tanë. Ne mbrojmë informacionin e nxënësve dhe autoritetet e zbatimit të ligjit që nuk janë autoritete vendore, përfshirë Shërbimin e Imigracionit dhe Doganave (Immigration and Customs Enforcement, ICE), nuk lejohen të kenë akses te nxënësit, shkollat ose të dhënat tona, përveç rasteve kur kjo kërkohet me ligj dhe pas konsultimit me avokatët e NYCPS-së.

Jemi të vetëdijshëm se shqetësimet që lidhen me emigracionin mund të krijojnë pasiguri për fëmijët dhe familjet. Gjithashtu, e kuptojmë se disa anëtarë të komuniteteve tona shkollore mund të preken nga ndryshimet në programet e emigracionit, përfshirë Statusin e Përkohshëm të Mbrojtur (TPS). Shkolla juaj është këtu për t'ju mbështetur. Nëse ju ose një anëtar i familjes suaj keni pyetje ose shqetësime lidhur me ndryshimet që mund të ndikojnë te familja juaj, flisni me drejtorin/drejtoreshën e shkollës suaj për t'u lidhur me Project Open Arms (Projekti “Me krahë hapur”). Nëpërmjet Project Open Arms (Projekti “Me krahë hapur”) dhe partnerëve tanë në qytet, familjet mund të kenë akses në informacion lidhur me njohjen e të drejtave të tyre dhe në ndihmë juridike falas dhe konfidenciale në çështjet e emigracionit, për t'i ndihmuar të kuptojnë mundësitë e tyre dhe të lidhen me burime të besueshme.

Me fillimin e vitit të ri shkollor, gjithashtu i inkurajojmë familjet të sigurohen që informacioni i kontaktit të emergjencës i shkollës së tyre të jetë i përditësuar dhe të shqyrtojnë burimet e disponueshme nëpërmjet [Project Open Arms \(Projekti “Me krahë hapur”\) të NYCPS-së](#). Familjet kanë në dispozicion shërbime përkthimi dhe interpretimi, sipas nevojës. Për më shumë informacion, vizitoni schools.nyc.gov/ProjectOpenArms.

Për më tepër, NYCPS-ja vazhdon të bashkëpunojë me Zyrën e Kryetarit të Bashkisë për Çështjet e Imigrantëve (MOIA). Ju inkurajojmë të përdorni linjën telefonike të ndihmës ligjore të MOIA-s, në numrin 1-800-354-0365, e cila është falas, e sigurt dhe konfidenciale, ose të vizitoni nyc.gov/immigrants për të mësuar më shumë.



Jam krenar t'ju mirëpres ju dhe fëmijët tuaj në vitin shkollor 2026-2027. Çdo nxënës meriton të mësojë në një shkollë ku ndihet i sigurt, i vlerësuar dhe i mbështetur.

Në bashkëpunim,

Kamar H. Samuels
Kancelar (Chancellor)